



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:075811

Datë: 17.05.2019

Numri i dokumentit: 00316523

PKR.nr. 27/2019

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, duke vendosur sipas kryetarit të trupit gjykues Naser Maliqi, me sekretaren juridike Fikrete Destani, në çështjen penale ndaj të pandehurit A. H. nga fshati Cernië, Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzes së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti për Krimet e Rënda, PP.I.nr.27/2019 të dt. 21.02.2019, e pas mbajtjes e shqyrtimit fillestar dhe publik me dt.16.05.2019, shpallë:

AKTGJYKIM

Ndaj të pandehurit A. H. nga i ati dhe e ëma, e lindur, i lindur më datën, në Gjilan, jeton në fshatin Cernië, Komuna e Gjilanit, ka të kryer shkollën e mesme, punon si kamarier, i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTE FAJTOR

Sepse, në kohë të papërcaktuar e deri më datë 31.01.2019 i pandehuri A. H., ka siguruar dhe mbajtur në pronësi, pa leje përkatëse nga ana e organit kompetent një armë-revole të modelit “Ecol Jackal”, e cal. 9mm, me nr. serik 12120076, e cila më datën e lartëcekur i është konfiskuar nga ana e policisë gjatë bastisjes në shtëpinë e tij në fshatin Cërnice, Komuna e Gjilanit

-me çka ka kryer veper penale, mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 paragrafi 1 te KPRK-se.

Andaj në bazë të nenit 4,41,42,43,46,69,73,74,75,76 dhe,365 e 450 të KPPK-së.

E GJYKON

Me denim me gjobë në shumë prej 300 €(treqind euro) , të cilën gjobë i pandehuri do ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, ashtu që për çdo 20 euro të dënimit me gjobë do të llogaritet me 1 (një) ditë burgim.

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor, kësaj gjykate t'i paguaj shumën prej 20 euro, ndërsa shpenzimet e procedurës do të paguhet sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate.

Konfiskohet: armë-revole të modelit “Ecol Jackal”, e cal. 9mm, me nr. serik 12120076 dhe e njëjta armë të asgjësohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A R S Y E T I M

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, me dt. 21.02.2019, ka ngritur aktakuzën PP/I.nr.27/2019, ndaj të pandehurit A. H., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së, duke kërkuar që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave, i pandehuri të shpallet fajtor për veprën penale që i vihet në barrë duke marrë parasysh me këtë rast të gjitha rrethanat e kryerjes së veprës penale edhe të dënohet me dënim meritore sipas ligjit.

Kryetari i trupit gjykues, me datën 16.05.2019, ka mbajtur seancën e shtimit fillestar, ku është lexuar aktakuza e prokurorit të shtetit dhe pas leximit të aktakuzës i pandehuri A. H. ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet duke shtuar se e pranon fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale.

Gjatë shqyrtimit fillestar dhe publik kryetari i trupit gjykues pas dëgjimit të pandehurit dhe prokurorit të shtetit, ka marrë aktvendim me të cilin ka aprovuar pranimin e fajësisë, nga se janë plotësuar kushtet ligjore dhe ky pranim i fajësisë është vullnetar, pa imponim, duke i ditur pasojat e pranimit të faj sise, në përputhje me provat që gjenden në shkresat e lëndës edhe atë: raporti i hetimeve, raporti i bastisjes, raporti fillestar i incidentit, foto albumi, deklarata e të pandehurit si dhe raporti mbi konfiskimin e armës.

Kryetari i trupit gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se e njëjta nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjatë matjes dhe shqiptimit të dënimit, konform dispozitave 73 dhe 74, dhe 76 të KPRK gjykata ka marrë për bazë rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Në këtë aspekt kryetari i trupit gjykues si rrethana lehtësuese për të pandehurin ka marrë pranimin e fajësisë, njëkohësisht është i moshës së re, është penduar dhe ka kërkuar falje për kryerjen e

kësaj veprë penale dhe i premtion gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsëris vepra tjera penale, ndërsa gjykata nuk gjeti rrethana renduese për të pandehurin.

Sipas Kryetarit të Trupit Gjykses, dënimi me gjobë në shumë prej 300 euro është në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit si dhe gjendjen financiare të tij, andaj konform nenit 41 të KPRK-se gjykata vlerëson se me këtë dënim me gjobë do të arrihet qëllimi i dënimit i cili konsiston në parandalimin e kryesit që në të ardhmen të kryej vepra tjera penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave te tjerë ne kryerjen e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata në pajtim me dispozitat e nenit 374 paragrafi 3 të KPRK-se, të pandehurit i ka konfiskuar armën e markës “Ecol Jackal”, e cal. 9mm, me nr. serik 12120076 dhe pas plotfuqishmërisë e njëjta të asgjësohet.

Gjykata ka detyruar të pandehurin që kësaj gjykate t’ia paguaj shumën paushallë në vlerë prej 20 euro, ndërsa shpenzimet e procedurës sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
Me dt. 16.05.2019

Sekretare juridike ,
Fikrete Destani

Kryetari i trupit gjykses:
Naser Maliqi

KSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, palët e pakënaqura mund të ushtrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2019:075811
Datë: 17.05.2019
Numri i dokumentit: 00316523